



Pranuar / Dorezuar Pritjenj/Prodato Received/Delivery		26.05.2023	3 viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHCK	4479/2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.645/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.645/2023 të datës 18.04.2023, të parashtruar nga ankuesi _____ kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 25.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.645/2023 e datës 18.04.2023, e parashtruar nga ankuesi _____

II. *Mbetet në fuqi* Vendimi Nr.Ref 07/1-01SAP-P/3961 i datës 27.03.2023, i Drejtorit të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësi _____ i punësuar në Policinë e Kosovës, me datë 18.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.Ref 07/1-01SAP-P/3961 të datës 27.03.2023 të Drejtorit të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës, për shkak të shkeljeve procedurale dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Policinë e Kosovës. Ndërsa, Këshilli me datë 17.05.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3620/2023 të datës 18.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin Nr.Ref 07/1-01SAP-P/3961 të datës 27.03.2023 të Drejtorit të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.05.2023; Vendimin e datës 03.05.2007 me Nr.ref. KPS/DP/AP/3129/D të Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës; Vendimin e datës 09.02.2023 me Nr.ref.07/1-01SAP-P/1992 për arritjen e moshës së pensionimit; vërtetim për punësim i datës 09.02.2023 me nr.ref.07/1-01SAP-P/2020 dhe Kontratën e Punës për kohë të pacaktuar të datës 02.06.2014.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovë, ka nxjerr Vendimin me numër të referencës 07/1-01SAP-P/1992 të datës 09.02.2023 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të ankuesit me datë 05.03.2023, duke i njohur të njëjtit të drejtën e kompensimit të tri (3) paga mujore në vlerën e pagës së fundit mbi bazën e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021, ndërsa, me datë 27.03.2023 Drejtori e Personelit nxjerr Vendimin me numër reference 07/1-01SAP-P/3961, me të cilin ka anuluar pjesërisht Vendimin me numër të referencës 07/1-01SAP-P/1992 të datës 09.02.2023 lidhur me pjesën e së drejtës në kompensim, me arsyetimin së më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është shfuqizuar çdo dispozitë ligjore që rregullon çështjen e pagës edhe kompensimeve.

Ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshill duke kundërshtuar Vendimin me numër reference 07/1-01SAP-P/3961 të datës 27.03.2023, për shkak të shkeljeve procedurale dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Vendimin me numër reference 07/1-01SAP-P/3961 të datës 27.03.2023 dhe të le në fuqi Vendimin nr. referencës 07/1-01SAP-P/1992 të datës 09.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, dhe si rrjedhojë bazuar në vlerësimin e shkresave të lëndës ka konstatuar së Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës me nxjerrjen e vendimit të kontestuar përkatësisht Vendimit me numër reference 07/1-01SAP-P/3961 të datës 27.03.2023, ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike lidhur me këtë çështje administrative, dhe ka aplikuar drejtë dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Rregullores 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik dhe Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kuptim të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, në fuqi nga data 05.02.2023, ku me nenin me nenin 45 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil;.... 2. Me hyrje



në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave të reja ligjore Kolegji konstaton me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik pagat, shtesat dhe kompensimet tjera mund të përfitohen vetëm në pajtim me dispozita ligjore të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e ligjit


Andaj, nisur nga përcaktimi ligjor si me sipër, e duke qenë së ankuesi ka arritur moshën e pensionimit me datë 05.03.2023, pra në kohën kur është i zbatueshëm Ligji Nr.08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik, rrjedhë së Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër reference 07/1-01SAP-P/3961 të datës 27.03.2023, ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, sepse Ligji Nr.08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik nuk parasheh ndonjë lloj pagese apo kompensimi me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të nëpunësit civil, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara ligjërisht.

Theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1.1 nen paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.645/2023

Sabile AVDYLI



Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

